



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Për:	Menaxherin e Prokurimit: K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A “EUROPRINTY” SHPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 211/19
Prej:	Hysni Muhadri – Ekspert shqyrtues i prokurimit <i>Muhadri</i>		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 211/19 të parashtruar nga OE “EUROPRINTY” SHPK – Prishtinë.		
Datë	30.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 13.05.2019, me nr. 211/18 të parashtruar nga OE “EUROPRINTY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me material për zyre”, me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – “EUROPRINTY” SHPK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EUROPRINTY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me material për zyre”, me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ).



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		20.05.2019	30.05.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 13.05.2019, OE **“EUROPRINTY” SHPK** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me material për zyre”**, me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ)**.

Nuk është përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “EUROPRINTY” SHPK – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **“EUROPRINTY” SHPK** - Prishtinë, janë:

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;

Neni 61 – Tenderët Jo-Normalisht të Ulët;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“EUROPRINTY” SHPK** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me material për zyre”**, me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ)**.

Pasi kemi bërë kërkesën për rishqyrtim pran AK-së, na është refuzuar kërkesa me arsyetimin se kemi ofruar çmim jo normalisht të ulët, por ne si OE dhe palë e interesuar konform ligjit kemi paraqitur ankesën pasi pretendojmë se jemi dëmtuar me këtë aktivitet:

Ne si OE të eliminuar nga ky tender e kundërshtojmë si të pa bazuar vendimin e AK-së për eliminimin tonë, për vlerësim dhe vendim për dhënie të kontratës fitues në fjalë, për arsyet si në vijim:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutoj asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE.

Po ashtu është bërë shkelje e dispozitave ligjore neni 59 i LPP-së, pasi komisioni i vlerësimit nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve në mënyrë të duhur, duke anashkaluar krahasimin e saktë të tenderëve, siç ishte rasti jonë me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues shpall fitues OE me çmim më të lartë se kompania jonë, e që ka qenë i treti në listën e çmimeve, dhe në këtë rast AK-së e ka anashkaluar edhe një operator tjetër që ka dalë i dyti, e që nuk e përmbush as 10% të diferencës me ne, dhe 16 % me OE e dytë.

Në këtë aktivitet si kriter për dhënie të tenderit ka qenë çmimi më i ulët, po me këtë rast është bërë shkelje e nenit 61 të LPP-së.

Edhe përkundër përgjigjes së letrës standarde për sqarimin e tenderit në lidhje me çmimin e kërkuar nga AK-së, ku ne si OE pjesëmarrës ju kemi përgjigjur pozitivisht, ne ju kemi sqaruar mirë këto çmime, AK-së prapë ka bërë dallimin dhe favorizon OE NTP "VERTIGO", DUKE E SHPELLUR FITUES, si për dëshmi kemi vërejtur se qysh para publikim të këtij tenderi shihet çart se i është dedikuar për OE fitues, pasi që tek përshkrimi i çmimeve në formatin Excel figuron emri i OE "VERTIGO", për këtë mundet me verifikua edhe vet eksperti shqyrtues i caktuar për këtë lëndë.

Andaj në bazë të atyre që lartëcekëm ne si operator pjesëmarrës dhe palë e interesuar kërkojmë që ky tender të Ri-vlerësohet.

Të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues "EUROPRINTY" SHPK - Prishtinë, janë të shënuar në ankesë:

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	01.03. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës.....	116.287,23 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	26.03.2019
Data e hapjes së ofertave.....	26.03.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	13.04.2019
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.....	25.04.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim “EUROPRINTY” SHPK	26.04.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: “EUROPRINTY” SHPK	08.05.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr Ligjit Nr. 04 L-042. , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-09.

Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Një formularë ekstrakt nga “regjistri gjyqësor”

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
2. Vërtetim nga Administrata Tatimore .(original ose kopje e noterizuar)(vlen për OE fitues para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës).
3. Vërtetimi i gjykatës -(original ose kopje e noterizuar)(vlen për OE fitues para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës).

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “EUROPRINTY” SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me material për zyre”, me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ).

duke iu referuar nenit 65, paragrafi 3, nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.	
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. 2. Regjistrimi i numrit fiskal 3. Regjistrimi i TVSH-së	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje) 2. Certifikata e numrit fiskal (kopje) 3. Certifikatës e TVSH-së (kopje)
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: - 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2 furnizime të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Një listë e furnizimeve duke saktësuar furnizimet e kryera ,shumën e kontratave dhe kohën duke ia bashkangjitur së paku dy referenca ose procese të pranimit të furnizimeve të ngjashme.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi	Çmimi me TVSH	Vërejtje
1.	"MEDIATECH & PRINT SHPK"	Prishtinë	33,698.86 €	39,764.65 €	JO
2.	NPT "KGT"	Prishtinë	71,059.54 €	83,850.25 €	JO
3.	"IT MARKET" SHPK	Prizren	24,791.80 €	29,254.30 €	JO
4.	NTP "VERTIGO"	Prizren	27,840.77 €	32,852.11 €	JO
5.	"A.R.F SHPK"	F. Kosovë	32,830.17 €	38,739.60 €	JO
6.	"EUROPRINTY SHPK"	F. Kosovë	23,803.38 €	28,088.00 €	JO

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EUROPRINTY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material për zyrë", me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ).

7.	"INFOSOFT OFFICE SHPK"	Prishtinë	46,691.99 €	55,096.55 €	JO
8.	NTSH "OFFIC –TRADE"	Prishtinë	39,153.17 €	46,200.75 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Artan Muja– Kryetar i komisionit
- Jashar Biba – Anëtar i komisionit
- Fatbardh Kryeziu – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi	Çmimi me TVSH
1.	NTP "VERTIGO"	Prizren	27,840.77 €	32,852.11 €
2.	"MEDIATECH & PRINT SHPK"	Prishtinë	33,698.86 €	39,764.65 €
3.	NTSH "OFFIC –TRADE"	Prishtinë	39,153.17 €	46,200.75 €
4.	"INFOSOFT OFFICE SHPK"	Prishtinë	46,691.99 €	55,096.55 €
5.	NPT "KGT"	Prishtinë	71,059.54 €	83,850.25 €

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhur në përfundim se nga tetë (8) OE pjesëmarrës, pesë (5) nga ta kanë ofruar tender të përgjegjshëm dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "VERTIGO" -Prizren, me çmim 32,852.11 €.

Rekomandimi i komisionit është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EUROPRINTY" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material për zyre", me numër të prokurimit: HJ-19-010-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A (HJ).

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se AK-së ka kërkuar përmes Letrës standarde për sqarime të çmimeve ka kërkuar sqarime nga OE "EUROPRINTY" SHPK, për çmim jo normalisht të ulët.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues sqaron se me dt:15.04.2019, i jep sqarime AK-së në lidhje me çmimet jo normalisht të ulët.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se AK-së me dt:25.04.2019, përmes Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar i drejtohet OE ankues "EUROPRINTY" SHPK, ku i thotë:

Oferta juaj konsiderohet jo normalisht i ulët sipas rregullores B57.

1. Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 7 oferta të përgjegjshme;
2. Plotëson edhe kushtin e dytë (30%) sepse çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve;
3. Plotëson edhe kushtin e tret – çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët;

Andaj lidhur me arsyen e eliminimit nga AK-së, ku e eliminon OE ankues me arsyetimi se ka ofruar tender me çmim jo normalisht të ulët, si dhe duke pasur parasysh pretendimin OE ankues ku pretendon se oferta e tyre nuk është ofertë me çmim jo normalisht të ulët, eksperti shqyrtues pas analizimit të çmimeve të ofertave të përgjegjshme, sipas Rregullores për çmime jo normalisht të ulët të aprovuar nga KRPP, rezulton se pragu për tu konsideruar ofertë me çmim jo normalisht të ulët janë të gjitha ofertat deri në vlerën prej 35,788.19 €.

Eksperti shqyrtues sqaron se gjatë vlerësimit nuk është marrë parasysh neni 61 të LPP-së, si dhe nuk është marr parasysh Rregullorja për çmime jo normalisht të ulët e aprovuar nga KRPP-ja.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Operatori ekonomik pretendon se është qysh para publikim të këtij tenderi, shihet çart se ky tender i është dedikuar për OE fitues, pasi që tek përshkrimi i çmimeve në formatin Excel figuron emri i OE "VERTIGO", dhe ky pretendim mund të verifikohet edhe nga eksperti shqyrtues i caktuar për këtë lëndë.

Duke u bazuar në pretendimin e OE ankues "EUROPRINTY" SHPK, eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit

të këtij pretendimi dhe pas analizimit të përshkrimit të çmimeve në formatin Excel, të ngarkuar në e-prokurim, është e vërtetë që në fund të këtij përshkrimi del shënimi Vertigo .

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), dhe lënda të kthehet në rivlerësim.